



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 313 Prot.

Tiranë, më 18.03.2019

UDHËZIM

Nr. 02, datë 18.03.2019

PËR

NDJEKJEN, MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E PROCESIT TË HARTIMIT DHE
MIRATIMIT TË DOKUMENTEVE TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE

Në mbështetje të nenit 28, të Ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", neneve 3, 9, 13, 20, 23, 24 dhe 25, të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit", VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", si dhe në funksion të hartimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore nga autoritetet vendore duke siguruar transparencë, arritje të objektivave sipas përcaktimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe respektimi i legjislacionit sektorial në fuqi,

UDHËZOJ:

1. Autoritetet Vendore përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, duhet të bashkërendojnë punën dhe të bashkëpunojnë me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe çdo palë të interesuar, në mënyrë që të sigurojnë materiale dhe të dhëna të nevojshme për hartimin e dokumentit të PPV-së.
2. Autoriteteve Vendore përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ju vihen në dispozicion nga AKPT të dhëna dhe materiale të nevojshme, në ndihmë të këtij procesi.
3. Procesi i hartimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore përmban disa hapa, si më poshtë:

Faza 0: Ndërmarrja e Nismës nga autoritetet vendore, për hartimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor;

Faza I: Hartimi i dokumentit të "Analizës dhe Vlerësimit të Territorit";



Faza II: Hartimi i dokumentit të “Strategjisë Territoriale”;

Faza III: Hartimi i dokumentit të Planit të Zhvillimit të Territorit, të Rregullores së Planit, si dhe Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM);

Faza IV: Përgatitjen e paketës së plotë të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;

Faza V/a: Miratimi i paketës së plotë të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor në Këshillin Bashkiak;

Faza V/b: Miratimi i paketës së plotë të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT);

Faza VI: Konfirmimin (zbardhjen) e paketës së plotë të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Territorit (AZHT).

4. Monitorimi i procesit të hartimit të dokumentit të PPV-së kryhet nga AKPT, e cila në përfundim të secilës fazë, harton Raportin e Vlerësimit Teknik dhe Procesverbalin përkatës, me përjashtim të Fazës 0, për të cilën jep komente dhe sugjerime që mundësojnë përputhshmërinë e dokumentit.
5. Në përfundim të procesit të hartimit të dokumentit të PPV-së sipas fazave, përpara lëshimit të Aktit të Përputhshmërisë, AKPT realizon procesin e bashkërendimit/ mendimdhënies me institucionet qendrore, mbi draftin final të dokumentit të PPV-së.
6. Komentet/ sugjerimet e dhëna nga institucionet qendrore mbi draftin final të dokumentit të PPV-së, AKPT i vendos në dispozicion të autoriteteve vendore, të cilat më pas kanë detyrim reflektimin e tyre, në draft-dokumentin e PPV-së, ose argumentimin e mosreflektimit, sipas rastit.
7. Procesi i miratimit përfundimtar të dokumentit të plotë të PPV-së në Këshillin Kombëtar të Territorit, koordinohet nga AKPT, e cila harton raportin e bashkërendimit, orienton autoritetet vendore për përgatitjen e materialeve të nevojshme për prezantim në KKT. Paketa e plotë e prezantimit të dokumentit të PPV-së për miratim në KKT përgatitet nga AKPT dhe përcillet në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.
8. Pas miratimit të dokumentit të PPV-së në KKT, AKPT në bashkëpunim me AZHT ndjek procesin e konfirmimit dhe hyrjes në fuqi të këtij dokumenti. AKPT verifikon përmbajtjen dhe formën e dokumenteve përfundimtare përbërëse të dokumentit të PPV-së dhe i dërgon ato në AZHT për konfirmim.
9. Pas përfundimit të procesit të konfirmimit të dokumentit të plotë të PPV-së nga AZHT, kjo e fundit dërgon në AKPT materialet e sigluara. AKPT kryen botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të dokumentit të plotë të PPV-së të konfirmuar dhe njofton autoritetin vendor.
10. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi është Shtojca I, ku përcaktohet në mënyrë të detajuar procesi i ndjekjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit të procesit të miratimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, referuar pikave të sipërcituara të këtij Udhëzimi.



11. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat ndërmarrin nismën për hartimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.
12. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT, përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

DREJTORE E PËRGJITHSHME



UDHËZUES BASHKËRENDIMI

[Bashki-Konsulent-AKPT-AZHT]

PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE
NË KËSHILLIN BASHKIAK DHE KËSHILLIN KOMBËTAR TË TERRITORIT

Përmbajtja e Dokumentit

1. HAPAT
2. BASHKËRENDIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR PËRPUTHSHMËRINË E PPV
3. DOKUMENTET PËR SHQYRTIM
4. DOKUMENTET PËR PREZANTIM në KKT
5. DOKUMENTET PËR MIRATIM në KB dhe KKT
 - 5.1 Raportet
 - 5.2 Harta për Miratim në KKT dhe KB
 - 5.3 Harta për Miratim në KB
 - 5.4 Formati i Kapakut të Dokumenteve
 - 5.5 Formatet Tip të Hartave
6. PROJEKT-VENDIMI I MIRATIMIT TË PPV



1. HAPAT

1.1. Përgatitja për miratim

- 6.1.1 Përgatitja e dokumentit të plotë të PPV-së (*Bashkia/Grupi i Punës*);
- 6.1.2 Botimi në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) të dokumentit të plotë të PPV-së (*Bashkia*);
- 6.1.3 Dorëzimi i Deklaratës së Përgjegjësive Profesionale në Bashki (*konsulenti*) dhe botimi i saj në RKPT (*Bashkia*).

1.2. Shqyrtimi i përputhshmërisë (PPV + VSM)

- 1.2.1. Kërkesa zyrtare drejtuar AKPT për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për PPV-në (*Bashkia*);
- 1.2.2. Lëshimi nga AKPT i Aktit të Përputhshmërisë (*AKPT*);
- 1.2.3. Botimi në RKPT i Aktit të Përputhshmërisë (*AKPT*);
- 1.2.4. Kërkesa zyrtare drejtuar Ministrisë së Mjedisit për lëshimin e Deklaratës Mjedisore për VSM-në e PPV-së (*Bashkia*);
- 1.2.5. Lëshimi i Deklaratës Mjedisore (*Ministria e Mjedisit*);
- 1.2.6. Botimi në RKPT i Deklaratës Mjedisore (*Bashkia*).

1.3. Miratimi në KB

- 1.3.1. Kërkesa e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtim dhe miratim të PPV-së drejtuar Këshillit Bashkiak (*Bashkia*);
- 1.3.2. Lëshimi i Vendimit të miratimit të PPV (*Këshilli Bashkiak*);
- 1.3.3. Marrja e konfirmimit të vendimit të KB nga Prefekti i Qarkut (*Bashkia*);
- 1.3.4. Botimi në RIT i Vendimit të Këshillit Bashkiak dhe Konformitetit të Qarkut (*Bashkia*).

1.4. Miratimi në KKT

- 1.4.1. Kërkesa e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtim dhe miratim të PPV-së drejtuar KKT (*Bashkia*);
- 1.4.2. Bashkërendimi AKPT-AZHT përpara miratimit dhe zbardhjes së dokumenteve;
- 1.4.3. Lëshimi i Vendimit të miratimit të PPV (*KKT*);
- 1.4.4. Zbardhja dhe botimi në RKPT i Vendimit të KKT (*AKPT*);
- 1.4.5. Dërgimi pranë Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe autoritetit të planifikimit një kopje të dokumentit të planifikimit të miratuar, së bashku me vendimin e miratimit të tij (*AZHT*).

2. BASHKËRENDIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR PËRPUTHSHMËRINË E PPV

- 2.1. Dërgimi i draft-planeve të përgjithshme vendore për mendim drejt autoriteteve qendrore (ministritë sipas fushave të kompetencës, institucionet e vartësisë të ministrive);
- 2.2. Hartimi i Raportit të Bashkërendimit të PPV-së, për KKT (*AKPT*):
 - 2.2.1. FBPV (ftesat, pjesëmarrja, datat);
 - 2.2.2. PPV për mendim (shkresat, përgjigjet);



2.2.3. Takime të tjera (pjesëmarrja, datat).

- 2.3. Bashkërendimi i AZHT-së me AKPT-në për konfirmimin e materialeve që do të dorëzohen nga Bashkitë për miratim në KKT (për t'u siguruar që dokumentet janë konform standartit të kërkuar dhe nuk kanë pësuar ndryshime të pakonfirmuara). Bashkërendimi bëhet online/e-mail apo në mënyrë shkresore.

3. DOKUMENTET PËR SHQYRTIM

Materialet¹ që duhen botuar në RKPT nga *Bashkia* përpara miratimit të dokumentit të planifikimit në KB dhe KKT, janë:

3.1. Nisma e miratuar dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;

3.2. Dokumentet përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor:

- | | | |
|-------|---|--|
| TEKST | } | 3.2.1. Analiza dhe Vlerësimi i Territorit; |
| | | 3.2.2. Strategjia Territoriale; |
| | | 3.2.3. Plani i Zhvillimit të Territorit; |
| | | 3.2.4. Rregullorja e Planit; |
| | | 3.2.5. Vlerësimi Strategjik Mjedisor; |
| HARTA | } | 3.2.6. Materiali Hartografik shoqërues (<i>për secilin dokument më sipër</i>); |
| | | 3.2.7. Baza e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të RKPT. |

3.3. Deklarata e Përgjegjesisë Profesionale;

3.4. Akti i Përputhshmërisë nga AKPT ose Deklarata e Përputhshmërisë në Heshtje nga Bashkia;

3.5. Deklarata Mjedisore nga Ministri i Mjedisit për VSM-në.

4. DOKUMENTET PËR PREZANTIM² NË KKT

Për mbledhjen e KKT-së, duhet të përgatiten:

4.1. 1 kopje e dokumentit të plotë të PPV-së (*sipas pikave 5.1 dhe 5.2, më poshtë*);

4.2. 10 kopje të:

- i. Raportit përmbledhës (*tekst, max. 20 faqe*) të Planit të Përgjithshëm Vendor;
- ii. 6 hartave që miratohen nga KKT (*format A3*).

4.3. Prezantimi i PPV-së (*max. 10 min*), i ilustruar me harta, duke paraqitur³:

- i. *Vizionin Strategjik*.
 - Deklarata – me fjalë kyçe;
 - Strategjia për zhvillimin ekonomik / modeli i rritjes ekonomike;
 - Projeksioni për punësimin/ rritjen e vendeve të punës sipas sektorit ekonomik;

¹ Botimi i këtyre materialeve kontrollohet dhe konfirmohet nga AKPT.

² Dokumentet për prezantim në Këshillin Bashkiak përkatës për çdo Bashki, i vendos vetë Bashkia sipas nevojave.

³ Për të paraqitur propozimet më thelbësore për anëtarët e KKT-së, brenda minutazhit të prezantimit, duhet të evitohen prezantimi i procesit, përmbajtjes apo metodologjisë së hartimit të PPV-së, pasi janë të njëjta për çdo PPV.



- ii. *Projeksioni i popullsisë;*
- iii. *Ndarjen e territorit në 5 sisteme (harta dhe tabela - duke evidentuar ndryshimet sipas propozimeve të reja, me argumentet përkatëse);*
- iv. *Propozimet konkrete dhe projektet e parashikuara, shoqëruar me shifrat përkatëse:*

Informacion përmbledhës:

- Grafiku i përqindjeve të projekteve sipas sektorëve mbi nr. total;
- Nr. i projekteve me rreze ndikimi vendbanimet; bashkinë, rajonin e më gjerë;
- Kosto e përgjithshme për realizimin e projekteve në 15 vjet, dhe sipas fazave
- Përqindja e investimeve që mund të realizojë bashkia me financat vendore;
- Përqindja e investimeve që kanë nevojë për mbështetje nga niveli qendror;
- Përqindja e investimeve që kanë nevojë për mbështetje nga sektori privat.

Sipas sektorit:

- Infrastrukturë (transport – km rrugë të propozuara për ndërtim dhe rikonstruksion + терминалет; energji; menaxhim mbetjesh – venddepozitime dhe/ose landfill; trajtimi i ujërave të ndotura);
- Turizëm (zonat e zhvillimit të turizmit, dhe sipas rastit marrëdhënia e tyre me zonat e mbrojtura mjedisore);
- Mjedis (propozimet për zgjerimin e zonave të mbrojtura, masat konkrete për burimet ujore dhe natyrore, trajtimi i hotspot-eve);
- Kulturë (propozimet rreth objekteve monument kulture apo zonave arkeologjike, propozime për shpallje monumentesh të reja);
- Bujqësi (propozimet për tregjet bujqësore, agroturizmin, evidentimi i produkteve lokale dhe potencialet ekonomike);
- Industri/Ekonomi (zonat e përqëndrimit të aktivitetit ekonomik, aktiviteti industrial, përfshirë miniera, industri e rëndë, e lehtë ku do të fokusohet zhvillimi ekonomik në bashki);
- Zhvillim Urban (ndërhyrjet kryesore urbane të propozuara – zgjerim urban dhe/ose rigjenerimi i hapësirave publike madhore).

- v. *Gjetjet e VSM-së.*

5. DOKUMENTET PËR MIRATIM në KB dhe KKT

- 5.1. RAPORTE⁴ – MIRATIM KB dhe KKT [Shoqëruar me kapakun për firmat, 5 kopje të printuara të secilit dokument]

- 5.1.1.Strategjia Territoriale;
- 5.1.2.Plani i Zhvillimit të Territorit;
- 5.1.3.Rregullorja e Planit.

⁴ Teksti i PPV-së duhet të jetë në formën e tij më të përmbledhur dhe të saktë, duke synuar dokumente të shkruara të reduktuara në faqe, pa humbur vlerat e planit.



5.2. **HARTA - MIRATIM KB dhe KKT** [Formati Tip 1, **5 kopje** të printuara të secilës nga 6 hartat e listuara]

5.2.1. **Harta e Vizionit Strategjik** (i gjithë territori bashkiak)⁵ me së paku informacionin:

- a. Baza:
 - *Kufiri administrativ (bashki, njësi);*
 - *Topografi;*
 - *Hidrografi;*
- b. Hierarkia e qendrave/vendbanimeve urbane;
- c. Zonat e Rëndësisë Kombëtare (natyrore, kulturore, etj.);
- d. Infrastruktura e rëndësisë kombëtare automobilistike, sipas rastit hekurudhore, portuale, aeroportuale; stacionet multimodale;
- e. Infrastruktura e rëndësisë kombëtare energjetike;
- f. Zonat ekonomike, lidhjet mes tyre dhe lidhjet me infrastrukturën e transportit/shërbimit;
- g. Rajonalizimi i mbetjeve;
 - h. Korridoret e gjelbra lidhëse - zonat buferike të trupave ujorë;
 - i. Tokat bujqësore.

5.2.2. **Harta e Sistemeve Territoriale të Propozuara** (i gjithë territori bashkiak) me së paku informacionin:

- a. Baza:
 - *Kufiri administrativ (bashki, njësi);*
 - *Topografi;*
 - *Ndërtime ekzistuese të azhornuara;*
 - *Rrjeti rrugor i propozuar.*
- b. 5 Sistemet (UB, IN, U, B, N);
- c. Zonat e Rëndësisë Kombëtare, me nën-ndarjet përkatëse (Zona të Mbrojtura; Monumente/ Zona Arkeologjike, etj., ZRK nga Vendime të KKT);
- d. Tabela e treguesve, për secilin sistem:
 - *Sip. ekzistuese;*
 - *Sip. e propozuar;*
 - *Ndryshimi ne %.*
- e. Evidentimi i territoreve që pësojnë konvertim.

5.2.3. **Harta e Ndarjes së Territorit në Zona dhe Njësi** (i gjithë territori bashkiak) me së paku informacionin:

- a. Baza:
 - *Kufiri administrativ (bashki, njësi administrative);*

⁵ Shkalla dhe mënyra e prezantimit (faqosja) e secilës hartë vendoset në varësi të madhësisë së territorit të Bashkisë përkatëse – parimi udhëheqës është përcjellja e informacionit të hartës në mënyrë të qartë dhe të lexueshme.



- *Topografi;*
 - *Ndërtime ekzistuese te azhornuara;*
 - *Rrjeti rrugor i propozuar;*
- b. Kufij zona;
- c. Kodet e zonave;
- d. Kufij njësi;
- e. Kodet e njësave;
- f. Zonat e Rëndesise Kombëtare me nën-ndarjet përkatëse.

5.2.4. Harta e Përdorimit të Propozuar të Tokës (i gjithë territori bashkiak) me informacionin:

- a. Baza:
- *Kufiri administrativ (bashki, njësi);*
 - *Topografi;*
 - *Ndërtime ekzistuese të azhornuara;*
 - *Rrjeti rrugor i propozuar;*
- b. Kufij njësi;
- c. 22 Kategoritë e përdorimit të tokës (me ngjyrat e përcaktuara), apo kombinimet e tyre.

5.2.5. Harta e Infrastrukturës së Transportit të Propozuar (i gjithë territori bashkiak) me së paku informacionin:

- a. Baza:
- *Kufiri administrativ (bashki, njësi);*
 - *Topografi;*
 - *Ndërtime ekzistuese të azhornuara;*
- b. Infrastruktura rrugore; sipas rastit dhe ajo hekurudhore; portuale; aeroportuale e propozuar;
- c. Hube / Stacione multimodale / Terminale;
- d. Prerjet e rrugëve, sipas kategorive / tipologjive;

5.2.6. Harta e Fazave të Zbatimit të PPV-së (i gjithë territori bashkiak) me së paku informacionin:

- a. Baza:
- *Kufiri administrativ (bashki, njësi);*
 - *Topografi;*
 - *Ndërtime ekzistuese te azhornuara;*
 - *Rrjeti rrugor i propozuar;*
- b. Kufij zona/njësi;
- c. Fazimi/kategorizimi sipas:
- Zonave / Njësave me prioritet zhvillimi (ekonomik dhe urban);
 - PDV-ve;
 - Rrjeteve kryesore të infrastrukturave publike;
 - Projekteve prioritare/strategjike dhe projekteve pilot.

*** Shënim i përgjithshëm:**

Në çdo rast, hartat e PPV-së duhet të përmbajnë informacionin përtej kufirit administrativ të bashkisë përkatëse:

- kufijtë dhe emërtesat e bashkive fqinje;
- rrjeti rrugor, e sipas rastit hekurudhor;
- rrjeti hidrografik;
- zonat e mbrojtura mjedisore.

SHËNIM 1: Dokumentet e mësipërme të printuara duhet të dorëzohen në Bashki / Këshillin Bashkiak dhe në AKPT, për t'u përcjellë më pas në Ajencinë e Zhvillimit të Territorit (Sekretariati i KKT-së).

SHËNIM 2: Në secilën kopje të secilit dokument të mësipërm (tekst dhe hartë), firmosin:

- Kryetari i KKT-së;
- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Kryetari i Këshillit Bashkiak;
- Kryetari i Bashkisë.

SHËNIM 3: Pesë (5) kopjet e printuara dhe të firmosura, që marrin fuqi ligjore, shpërndahen në:
- Bashki, KM, AZHT, AQTN.

5.3. HARTA - MIRATIM vetëm në KB [Formati Tip 2, 1 kopje e printuar e secilës nga hartat]

Nga hartat shoqëruese të dokumenteve të PPV-së sipas Rregullores së Planifikimit, Këshilli Bashkiak miraton, përveç 6 hartave të mësipërme që miratohen edhe në KKT, të gjitha hartat e tjera ku reflektohen PROPOZIME të planit, që i përkasin Strategjisë Territoriale dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

Në secilën kopje të këtyre hartave, firmosin:

1. Kryetari i Këshillit Bashkiak;
2. Kryetari i Bashkisë.

SHËNIM 1: Hartat e mësipërme të printuara duhet të dorëzohen në Bashki / Këshillin Bashkiak për t'u firmosur dhe botuar më pas në RKPT.

SHËNIM 2: Në format të printuar, në Bashki duhet të dorëzohet gjithashtu 1 kopje e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit dhe hartave shoqëruese të saj.



5.4. FORMATI I KAPAKUT TË DOKUMENTEVE (referuar pikës 5.1)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z./Znj. _____

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. __ Datë __. __. __

Kryetar i Bashkisë

Z./Znj. _____

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË _____

STRATEGJIA TERRITORIALE

(ose PLANI I ZHVILLIMIT, ose RREGULLORE E PLANIT)

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. __, Datë __. __. __

DPKZHT: *(emri dhe firma e drejtuesit të drejtorisë së planifikimit në bashki)*

KONSULENT “_____”: *(emri i përfaqësuesit ligjor)*, Nr. Liç. _____



5.5. FORMATET TIP TË HARTAVE⁶

5.5.1. TIPI 1 – 6 Hartat për Miratim në KKT dhe KB

Titujt e hartave:


1. Harta e Vizionit Strategjik;
2. Harta e Sistemeve Territoriale të Propozuara;
3. Harta e Ndarjes së Territorit në Zona dhe Njësi;
4. Harta e Përdorimit të Propozuar të Tokës;
5. Harta e Infrastrukturës së Transportit të Propozuar;
6. Harta e Fazave të Zbatimit të PPV-së.

⁶ 1. Hartat e PPV-së firmosen nga profesionet me kontribut në hartimin e planit, të cilët mbajnë përgjegjësi për produktin – sipas rastit mund të shtohen të tjerë, apo të modifikohen ato që janë specifikuar. Për secilin ekspert duhet të jepet nr. i identifikimit profesional (nr. Liçence apo në mungesë, nr. diplome).

2. Legjenda e dhënë i përket 22 kategorive të përdorimit të tokës, ndërkohë sipas hartës duhet të shtohen të gjithë elementet e tjerë grafikë që duhet të pajisen me shpjeguesin përkatës.



PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË
DARTIA E



REPUBLIKA E SHqipërisë
KESHILLI KOMBETAR I TERRITORT

MINISTRI
DRTARIAK
Z. LIDI BASHA

MINISTRI I MAMANTIMIT DHE TËRHEQJES
Z. DASHAN GJINJERI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Z. Zog

Kryetari i Bashkisë
Z. Zog

PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR I Bashkisë
DARTIA E

Titulli i hartës: _____
Skala: _____
Data: _____




ANEXUMI I KESHILLIT KOMBETAR I TERRITORT

Emri i bashkisë	Simboli	Shprehja
1. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
2. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
3. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
4. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
5. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
6. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
7. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
8. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
9. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
10. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
11. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
12. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
13. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
14. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
15. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
16. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
17. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
18. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
19. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
20. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
21. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
22. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
23. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
24. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
25. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
26. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
27. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
28. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
29. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
30. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
31. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
32. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
33. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
34. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
35. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
36. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
37. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
38. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
39. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
40. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
41. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
42. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
43. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
44. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
45. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
46. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
47. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
48. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
49. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë
50. Rrjetë	[Symbol]	Rrjetë



5.5.3. TIPI 3 – Hartat e Analizës Territoriale / Gjendjes Ekzistuese të Territorit



6. PROJEKT-VENDIMI PËR MIRATIMIN E PPV-së

- 6.1. Projekt-Vendim për miratimin e "Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë _____".
- 6.2. Pjesë përbërëse e dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor janë:
- 6.2.1.Strategjia Territoriale;
 - 6.2.2.Plani i Zhvillimit të Territorit;
 - 6.2.3.Rregullorja e Planit.
 - 6.2.4.Hartat:
 - 6.2.4.1. Vizioni Strategjik;
 - 6.2.4.2. Sistemet Territoriale;
 - 6.2.4.3. Ndarja e Territorit në Zona dhe Njësi;
 - 6.2.4.4. Përdorimi i Tokës;
 - 6.2.4.5. Infrastruktura e Transportit;
 - 6.2.4.6. Fazat e Zbatimit të PPV-së.
- 6.3. Ngarkohet Bashkia _____ si autoriteti përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit të saj administrativ, për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.
- 6.4. Gjatë hartimit të planeve të detajuara vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti për zhvillimin e territorit, autoriteti përgjegjës i planifikimit duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
- 6.5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e miratuara më parë në fushën e planifikimit të territorit (përfshirë studime urbanistike, plane, instrumente planifikimi, etj) të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë patur efekt në territorin administrativ të Bashkisë _____:
- 6.5.1. _____
 - 6.5.2. _____
 - 6.5.3. _____
 - 6.5.4. _____

